



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 32

2000

Tetor

### P Ë R M B A J T J A

Vendim i Kuvendit nr.457, datë 26.10.2000	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Edi Rama nga detyra e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve .....	1583
Vendim i Kuvendit nr.458, datë 26.10.2000	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zonjës Esmeralda Uruçi Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.....	1583
Vendim i KM Nr.468, datë 31.8.2000	Për miratimin e protokollit të bisedimeve për bashkëpunimin financiar dhe teknik ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për vitin 2000.....	1584
Vendim i KM Nr.473, datë 31.8.2000	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i ujësjellësit dhe të kanalizimeve të qytetit të Korçës.....	1584
Vendim i KM nr.475, datë 31.8.2000	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit në zonën e plepave, Durrës, të segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë.....	1585

Vendim i KM nr.477, datë 31.8.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.51, datë 17.2.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr.248, datë 25.3.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit dhe kategorisë së telefonave celularë, në përdorim të institucioneve buxhetore””.....	1586
Vendim i KM nr.479, datë 31.8.2000	Për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncensionit, për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve, në aeroportin e Rinasit .....	1587
Vendim i KM nr.496, datë 21.9.2000	Për trajtimin me pagesë minimale të punonjësve të Fabrikës së Çimentos, Vlorë.....	1587
Vendim i KM nr.499, datë 21.9.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.....	1588
Vendim i KM nr.500, datë 21.9.2000	Për njësitë e shoqërisë “Armo”, sh.a. që nuk do të vlerësohen si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë.....	1589
Vendim i KM nr.506, datë 21.9.2000	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i kryqëzimit në zonën e plepave Durrës, pjesë e segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë.....	1594
Vendim i KM nr.509, datë 21.9.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.439, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, për bursat e shtetit dhe për pagesat e familjeve për nxënësit dhe studentët dhe për fëmijët që pranohen në shtëpitë e fëmijës, në institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë dhe në institutin me prapambetje të lehtë mendore”.....	1596
Vendim i KM nr.513, datë 21.9.2000	Për detyrimin e mjekëve, që duan të specializohen.....	1597
Vendim i KM nr.529, datë 5.10.2000	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë-Milot, në territorin e Komunës Milot.....	1598
Vendim i KM nr.532, datë 5.10.2000	Për miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin”.....	1599
Vendim i KM nr.545, datë 6.10.2000	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Vorë, në territorin e bashkisë së Vorës, pjesë e superstradës rrugore Tiranë-Durrës.....	1600
Vendim i KM nr.547, datë 5.10.2000	Për projektin pilot të shtrirjes së sigurimeve shëndetësore në shërbimin parësor të Tiranës.....	1601

Vendim i KQZ nr. 39, datë 7.10.2000	Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 1 tetor 2000.....	1602
	Vendim (Për shpallje të zhdukur) .....	1604
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Dhimitër Avramit.....	1604
	Kërkesë për shpallje të vdekur të Lami Dudës.....	1605

**V E N D I M**  
**Nr.457, datë 26.10.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E ZOTIT EDI RAMA NGA DETYRA E MINISTRIT TË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98, pika 2 e Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2764, datë 17.10.2000 i Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Edi Rama nga detyra e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.458, datë 26.10.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZONJËS ESMERALDA URUÇI MINISTRE E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98, pika 2 e Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2765, datë 19.10.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zonjës Esmeralda Uruçi në detyrën e Ministres së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.468, datë 31.8.2000**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR VITIN 2000**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e protokollit të bisedimeve për bashkëpunimin financiar dhe teknik ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për vitin 2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

V E N D I M  
Nr.473, datë 31.8.2000

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË  
PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT DHE TË KANALIZIMEVE TË QYTETIT TË  
KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 5, pika 1, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit për vitin 2000”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik dhe kompensimin e tokës bujqësore pronarëve që preken nga ndërtimi i ujësjellësit të qytetit të Korçës.
  2. Ky shpronësim bëhet në favor të Ministrisë së Punëve Publike.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 2 300 200 (dy milionë e treqind mijë e dyqind) lekësh.
  4. Punimet për ndërtimin e ujësjellësit dhe të kanalizimeve të qytetit të Korçës përfundojnë brenda 22 muajve nga lidhja e kontratës.
  5. Ministria e Punëve Publike, brenda fondit të programuar të investimeve për qytetin e Korçës, për vitin 2000, të bëjë likuidimin e pronarëve.
  6. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 2000.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E FAMILJEVE QË DO TË SHPËRBLEHEN NGA SHPRONËSIMET E  
NDËRTIMIT TË UJËSJELLËSIT**

Nr.	Emri, Mbiemri	Sipërfaqja e tokës sipas pronësisë m2	Njësia lekë/m2	Vlera në lekë
1.	Demir Njazi Bendo	390	700	273 000
2.	Agim Njazi Bendo	348	700	243 600
3.	Pragot Xhavit Bendo	348	700	243 600

4.	Bardhyl Sulejman Boshi	500	700	350 000
5.	Ylli Hamdi Myrtollari	500	700	350 000
6.	Artur Mehalla	500	700	350 000
7.	Viktor Bektash Kupe	100	700	70 000
8.	Dervish Bektash Kupe	100	700	70 000
9.	Muhamer Hamdi Myrtollari	500	700	350 000
	Shuma			2 300 200

**V E N D I M**  
**Nr.475, datë 31.8.2000**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË  
PREKEN NGA NDËRTIMI I KRYQËZIMIT NË ZONËN E PLEPAVE, DURRËS, TË  
SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik” dhe të nenit 9, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit, të vitit 2000” me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit rrugor në zonën e plepave, Durrës, pjesë e segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës së shpërblimit përkatës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 8 864 733 (tetë milionë e tetëqindëgjashtëdhjetekatër mijë e shtatëqindetridhjetetre) lekësh.

3. Fondi për shpërblimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, përballohet nga fondi i kontigjentit së Këshillit të Ministrave.

4. Ky shpronësim bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të përfundojë brenda muajit shtator 2000.

5. Punimet për ndërtimin e kryqëzimit rrugor fillojnë brenda muajit shtator dhe përfundojnë brenda 3 muajve nga dita e fillimit të tyre.

6) Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet

Nr.	Emri	Sipërfaqja në m2		Çmimi në L/m2	Vlera në lekë
		Tokë Bujq.	Truall		
1.	Sindikatat (në proces identifikimi)		2421	3661.6	8864733.6

**V E N D I M**  
**Nr.477, datë 31.8.2000**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.51, DATË 17.2.2000, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.248, DATË 25.3.1996, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMI E NUMRIT DHE KATEGORISË SË  
TELEFONAVE CELULARË, NË PËRDORIM TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në pikën 3, të vendimit nr.51, datë 17.2.2000, të Këshillit të Ministrave shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“I hiqet kufiri i shpenzimeve të përballeshme nga buxheti i shtetit, për përdorimin e telefonit celular edhe zëvendësministrit të Rendit Publik, drejtorit të Kabinetit të Kryeministrit, drejtorit të Departamentit të Informacionit, në Këshillin e Ministrave, drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe drejtorit të Policisë Kriminale”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.479, datë 31.8.2000**

**PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË KONCENSIONIT, PËR  
NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE, NË AEROPORTIN E RINASIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të neneve 21 dhe 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 7, të ligjit 8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, të ligjit nr.7638, datë CAPut! .11.1992, “Për shoqërinë tregtare”, dhe të neneve 5, 17, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Fillimin e procedurës së tenderimit, për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në aeroportin e Rinasit, me koncesion të formës BOOT.
2. Procedura e përzgjedhjes së investitorit të jetë tenderi i hapur, ndërkombëtar, me dy faza (faza e parë: parakualifikimi).
3. Realizimi i procedurave për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në aeroportin e Rinasit, me koncesion të formës BOOT, të bëhet me konsulencë ndërkombëtare.
4. Lejohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në emër të OSHA të prokurojnë fondin limit prej 43 500 000 (dyzetetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, me procedurën “Kërkesë për kuotim”, me shoqëritë konsulente, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Në buxhetin e shtetit, nga fitimi neto i vitit 1999 i “Albatransport” sh.a-së, të derdhen 43

500 000 lekë.

6. Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në buxhetin e vitit 2000, i shtohet, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, shuma prej 43 500 000 lekësh, si fond për prokurimin e shoqërisë konsulente.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

## **LISTA E SHOQËRIVE KONSULENTE**

ABM AMRO  
BANCA D'INTERNACIONALE MOBILIARE (IMI)  
CREDITANSALT INVESTMENT BANK  
CREDIT SUISSE FIRS BOSTON  
LAZARD VITALE BORGHESI&C  
MORGAN STANLEY  
NATIONAL BANK OF GREECE  
SBC ÄARBURG DILLON REED  
DELOITTE&TOUCHE  
PRICE ÄATER HOUSE COOPERS  
ÄSA-ÄILBUR SMITH ASSOCIATES  
EUROPEAN INVESTMENT BANK

## **V E N D I M**

**Nr.496, datë 21.9.2000**

### **PËR TRAJTIMIN ME PAGESË MINIMALE TË PUNONJËSVE TË FABRIKËS SË ÇIMENTOS, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 53, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të nenit 21 dhe 27, të ligjit 8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, të ministrit të Punëve Publike dhe të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

## **V E N D O S I:**

1. Punonjësit e fabrikës së çimentos, në Vlorë, të cilët deri më datën 30.4.1998 kanë qenë në marrëdhënie pune, përfitojnë një vit pagë minimale, në mbështetje të vendimit nr.203, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi".

Kjo pagesë ndërpritet për punonjësit të cilët kryejnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit dhe të vetëpunësimit, brenda periudhës së trajtimit me këtë pagesë.

Pagesa për këta punonjës të kryhet nga zyra e punës e rrethit të Vlorës.

2. Fondi prej 21 milionë lekësh për pagesën e këtyre punonjësve të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Periudha njëvjeçare për punonjësit që përfitojnë sipas këtij vendimi, të njihet si vjetërsi pune, për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës.

3. Fondi për detyrimet kontributive të papaguara për sigurimet shoqërore, të periudhës para datës 30.4.1998, të cilat arrijnë shumën 20 600 000 lekë, të përballohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga pagesa e qirasë së këtij objekti, e cila, për një vit, do të përdoret e gjitha për këtë qëllim.

4. Ministria e Punëve Publike të marrë masa për administrimin e dokumentacionit të fabrikës së çimentos, Vlorë.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

## V E N D I M

**Nr.499, datë 21.9.2000**

### **PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996, PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE, QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, lista e përcaktuar në pikat I dhe III ndryshohet dhe bëhet sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Funksionet kushtetuese dhe detyrat në administratën publike, që përfshihen për herë të parë në grupimet përkatëse, do të derdhin, sipas këtij vendimi, në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, kontributin e sigurimit shtetëror suplementar në përqindjet e caktuara në ligj, prej datës së emërimit të tyre në detyrë e në vazhdim.

3. Të gjitha institucionet, që përfshihen në skemën e sigurimit suplementar, sipas ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, duhet t’i përmbahen emërtimeve të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet listëpagesës që dorëzojnë pranë organeve të sigurimeve shoqërore.

4. Për çdo ndryshim të emërtimeve ose krijimit të emërtimeve të reja nga lista e miratuar, subjektet e interesuara duhet t’i paraqesin ndryshimet e tyre pranë Këshillit të Ministrave për miratim, në rast të kundërt organet e sigurimeve shoqërore nuk do të marrin parasysh kontributet e derdhura për emërtimet jashtë listës.

5. Në vendimin nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, pika II/2 e vendimit të ndryshohet si vijon:

“Departamenti i Administratës Publike, pranë Këshillit të Ministrave, përcakton pagën referuese të vendit të punës, kur në çastin e lindjes të së drejtës përfitime shtetërore suplementare nuk përmendet funksioni apo detyra që ka patur personi, pra nuk ka pagë të miratuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

LISTA PËR FUNKSIONET DHE DETYRAT TË CILAT MERREN PËR BAZË PËR PËRFITIME  
SIPAS LIGJIT NR.8500, DATË 10.06.1999 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8097,  
DATË 21.03.1996, “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË  
KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”

Për grupin e parë germa “a”, pika 8, e nenit 1, të këtij ligji:

- President i Republikës së Shqipërisë
- Kryetari i Kuvendit;
- Kryeministër;
- Zëvendëskryeministër;
- Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
- Zëvendëskryetari i Kryesisë së Kuvendit;
- Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;

Personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave janë:

- Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
- Kryetari i Gjykatës së Lartë;
- Kryetari i Komitetit të Ish-të Përndjekurve Politikë;
- Prokuror i Përgjithshëm;
- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Kryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;
- Kryetar i Komitetit Kombëtar të R.T.V.

Për grupin e parë germa “b”, e pikës 8, të nenit 1, të këtij ligji:

- Deputetët e Kuvendit;
- Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- Anëtarët e Gjykatës së Lartë;
- Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Avokati i Popullit

Për grupin e dytë germa “a”, e pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji:

- Sekretarët e Shtetit;
- Zëvendësministrat;
- Zëvendësprokurorët e Përgjithshëm;

dhe personat e tjerë të barazuar me ta si më poshtë:

- Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit;
- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave;
- Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës;
- Komisioner në Avokatin e Popullit;
- Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të R.T.V.;
- Kryetari i Akademisë së Shkencave;
- Kryetar i Komitetit të Zhvillimit dhe Turizmit;
- Kryetari i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
- Sekretari i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Drejtori i Përgjithshëm i R.T.V.-së;
- Drejtori i A.T.Sh-së;
- Zëvendëskryetar i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
- Drejtor i Departamentit pranë Kryeministrisë;
- Këshilltar i Kryeministrit;

- Shef i Kabinetit të Kryeministrit;
- Zëdhënësi i Kryeministrit;
- Zëvendëskryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Zëvendëskryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;
- Kryetari i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Shtetërore;
- Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- Drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik;
- Drejtori i Drejtorisë Qendrore të Shërbimit Qeveritar;
- Drejtori i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve;
- Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit;
- Zëdhënës i Kuvendit;
- Shef i Kabinetit të Kuvendit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Doganave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Financiare;
- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Tatimore;
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Kursimit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Tregtare Agrare;
- Kancelar i Gjykatës së Lartë;
- Prokuror i Gjykatës së Lartë;
- Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil;
- Shef i Kabinetit të Presidentit;
- Këshilltar i Presidentit;
- Zëdhënës i Presidentit;
- Prefekti;
- Kryetari i këshillit të rrethit;
- Kryetari i këshillit të qarkut;
- Kryetari i Bashkisë;
- Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese;
- Ndihmës i Kryeministrit;
- Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kontrollin e Figurave të Zyrtarëve;
- Kryekoordinator në Departamentin e Koordinimit në Këshillin e Ministrave;
- Kryetari i Grupit Mbikqyrjes të Shoqërive Huamarrëse;
- Ndihmës i Zv/Kryeministrit;
- Sekretar i Përgjithshëm në Prefekturë;
- Sekretar i Përgjithshëm në Këshillat e Rretheve;
- Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Qarkut;
- Sekretar i Përgjithshëm në Bashki;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Integritetit të Përndjekurve Politikë;
- Inspektor i Përgjithshëm i SHIK-ut;
- Sekretar i Përgjithshëm në Ministri.

Për grupin e dytë germa “b” e pikës 9 të nenit I të këtij ligji:

- Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave;
- Zëvendëskryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit;
- Sekretar Shkencor në Akademinë e Shkencave;
- President i Komitetit Olimpik Shqiptar;

- Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
- Kryetar i Agjensisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
- Kryetar i Agjensisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;
- Këshilltar i Zëvendëskryeministrit;
- Shef i protokollit dhe ceremonisë në Presidencë;
- Shef i zyrës së pritjes së popullit në Presidencë;
- Kryeinspektor në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Drejtor i Përgjithshëm në Ministri;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm në R.T.V;
- Drejtor i Radios së Jashtme;
- Drejtor i Radios së Brendshme;
- Drejtor i Televizionit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;
- Kryetar i Qendrës për Nxitjen e Investimeve të Huaja;
- Kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
- Kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimeve;
- Zëvendëskryetar i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Njesisë së Implementimit të Projektit Mobil;
- Shef i Shërbimit të Inspektoriatit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave;
- Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshëm të Aviacionit Civil;
- Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Ministrive dhe Institucioneve Qendrore;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtor i Ligjshmërisë në Gjykatën e Kasacionit;
- Drejtor i Përgjithshëm i ish-të Përndjekurve Politikë;
- Drejtor i Drejtorisë Kombëtare të Meteorologjisë dhe Kalibrimit;
- Drejtor i Drejtorisë së Standartizimit dhe Cilësisë;
- Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;
- Drejtor i Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
- Përgjegjës i Sektorit në Presidencë;
- Sekretar i Presidentit;
- Kryetar i Komisionit Shtetëror trepalësh për dhënien e Statusit të Ish-të Përndjekurve Politikë;
- Kryekëshilltar në Kuvend;
- Këshilltar Komisioni në Kuvend;
- Zëvendësdrejtor i A.T.Sh-së;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
- Zëvendëskryetar i Qendrës Shqiptare të Nxitjes së Investimeve të Huaja;
- Zëvendëskryetar i Agjensisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
- Zëvendësdrejtor i Agjensisë Kombëtare të Privatizimit;
- Zëvendësdrejtor i Agjensisë së Prokurimit Publik;
- Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
- Zëvendëspresident i Komitetit Olimpik;
- Këshilltar në Ministri dhe Institucione Qendrore;
- Drejtor Drejtorie (për probleme të veçanta) në Këshillin e Ministrave, Presidencë dhe Kuvend;
- Sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar;
- President i Këshillit Kombëtar të Urdhërit të Mjekut;
- Zëdhënës i Gjykatës së lartë;
- Shef Kabineti në Ministri dhe Institucione Qendrore;

- Drejtor i Përgjithshëm i Administratës së Përgjithshme të Ndhmës dhe Çështjeve Sociale;
- Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoriatit të Punës;
- Koordinator në Këshillin e Ministrave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Pyjeve dhe Kullotave;
- Kryeinspektor i Inspektoriatit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tij;
- Drejtor Drejtorie (Prokuror) në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Prokuror, Hetues, Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Prokuror në prokurorinë e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
- Zëvendësprokuror në Prokurorinë e Rrethit;
- Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
- Kryetar në Gjykatat e rretheve;
- Kryetar i Gjykatës së Apelit në rrethe;
- Prokuror rrethi;
- Zëvendësprokuror Rrethi;
- Zëvendëskryetar në Gjykatat e Rretheve;
- Zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit në Rrethe;
- Inspektor i Kontroll-Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave;

Për grupin e dytë germa “c” e pikës 9 të nenit 1, të këtij ligji:

- Drejtor Drejtorie në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Zëvendësdrejtor në Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Ambasador i Republikës së Shqipërisë;
- Ministër Fuqiplotë në Ambasadë;
- Shef sektori në Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Konsull në Konsullatat e Republikës së Shqipërisë;
- Kryetar dege në Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Ministër Këshilltar në Ambasadë;
- Këshilltar në Ambasadë;
- Sekretar i Parë në Ambasadë;
- Sekretar i Dytë në Ambasadë;
- Sekretar i Tretë në Ambasadë.

Për grupin e dytë germa “d” e nenit 9 të këtij ligji:

- Specialist në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Gjyqtarë në Gjykatat e Rretheve;
- Prokurorë;
- Hetues, oficer i Policisë gjyqësore;
- Gjyqtarë në Gjykatat e Apelit;
- Prokuror në Prokurorinë e Apelit;
- Sekretar i Kryetarit të Kuvendit;
- Sekretar i Kryeministrit;
- Atashe në Ambasadë;
- Asistent i Inspektorit të Kontroll - Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave.

**Shënim:**

1. Periudha që punonjësit ushtarakë përfitojnë nga ligji nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë“ përjashtohet.

**V E N D I M**  
**Nr.500, datë 21.9.2000**

**PËR NJËSITË E SHOQËRISË “ARMO”, SH.A. QË NUK DO TË VLERËSOHEN SI PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1, të ligjit nr.8582, datë 23.2.2000, “Për një shtesë në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë“, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në shoqërinë “Armo”, sh.a., Fier, nuk do të vlerësohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë, njësitë e mëposhtme:

1. Dega e karburanteve, Prenjas
  2. Dega e karburanteve, Tepelenë
  3. Dega e karburanteve, Bulqizë
  4. Dega e karburanteve, Pukë
  5. Dega e karburanteve, Kukës
  6. Dega e karburanteve, Burrel
  7. Dega e karburanteve, Tropojë
  8. Dega e karburanteve, Përmet
  9. Dega e karburanteve, Berat
  10. Dega e karburanteve, Peshkopi
  11. Uzina e përpunimit të naftës, Kuçovë
  12. Uzina e përpunimit të naftës, Cërrik
  13. Reparti i KMC në uzinën e përpunimit të naftës, Fier
  14. Pika e shitjes së karburanteve, Laç
  15. Pika e shitjes së karburanteve, Milot
  16. Pika e shitjes së karburanteve, Kurbnesh
  17. Pika e shitjes së karburanteve, Bishnicë, Pogradec
  18. Pika e shitjes së karburanteve, Vau i Dejës
  19. Pika e shitjes së karburanteve, Malësi e Madhe
  20. Pika e shitjes së karburanteve, Bahçallëk, Shkodër
  21. Pika e shitjes së karburanteve, Parku i Shkodrës
  22. Pika e shitjes së karburanteve, Bajram Curri
  23. Pika e shitjes së karburanteve, Fierzë, Tropojë
  24. Pika e shitjes së karburanteve, Sopot, Tropojë
  25. Pika e shitjes së karburanteve, Kam, Tropojë
  26. Pika e shitjes së karburanteve, Shemri, Kukës
  27. Pika e shitjes së karburanteve, Bulqizë
  28. Pika e shitjes së karburanteve, Peshkëpi, Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.506, datë 21.9.2000**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I KRYQËZIMIT NË ZONËN E PLEPAVE, DURRËS, PJESË E SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5, pika 1, dhe 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit rrugor në zonën e plepave, Durrës, pjesë e segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës së shpërblimit që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 12 106 748 (dymbëdhjetë milionë e njëqindëgjathtë mijë e shtatëqindëdyzetetë) lekësh.
4. Fondi për shpërblimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2000 i Ministrisë së Transportit, në zërin "Shpronësime".
5. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit tetor 2000.
6. Punimet për realizimin e projektit të fillojnë pas mbarimit të procedurave të shpronësimit dhe të mbarojnë brenda muajit nëntor 2000.
7. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Truall Nr. (1-3)

Nr.	EmërAtësi Mbiemër	V.K.K.K.P (datë)	Leje ndërtimi (datë)	Sip.trualli m2	Çmimi (lekë/ m2)	Vlera në (lekë)	Shënime
1.	Demir Xhafa	7.3.1994	23.9.1996	805 m2	26515	2134457	
	Demir Xhafa						Pretendim
2.	Rexhep Hersi	25.12.1995	23.9.1996	3230	26515	8564345	Pronësie
3.	Hamza Muça	4.7.1996	23.9.1996	531	26515	1407946	Në gjykim
	Shuma:			4566		12106748	

**V E N D I M**  
**Nr.509, datë 21.9.2000**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 9.9.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, PËR BURSAT E SHTETIT DHE PËR PAGESAT E FAMILJEVE PËR NXËNËSIT DHE STUDENTËT DHE PËR FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË DHE NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.8554, dsatë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", të nenit 32, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 63, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995, "Për sistemin arsimor, parauniversitar", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.439, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si vijon:

"Me propozimin e këshillave të komunave apo bashkive, këshilli i qarkut, (përjashtimisht për vitin 2000 prefekti), ka të drejtë të miratojë bursë ose gjysmëbursë, jashtë kriterit ekonomik, brenda planit të vitit të parë, si më poshtë:

- Rrethet deri në 3 bursa.
- Bashkia e Tiranës deri në 30 bursa".

2. Pika 12 ndryshon si vijon:

"Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor 2000-2001, i jepen 1000 bursa, për arsimin e lartë dhe 900 bursa, për arsimin e mesëm."

3. Pika 13 ndryshon si vijon:

"Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e dyta e sipër, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 30 tetor 2000".

4. Pika 14 ndryshon si vijon:

"Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 15 dhjetor 2000".

5. Pas paragrafit të parë të pikës 14, shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

"Personat përgjegjës ngarkohen të zhdëmtojnë shumat e marra padrejtësisht, me propozimin e organit të kontrollit dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror".

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe shkencës për zbatimin e këtij vendimi,

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.513, datë 21.9.2000**

**PËR DETYRIMIN E MJEKËVE, QË DUAN TË SPECIALIZOHEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të tetë, të nenit 13, dhe të paragrafit të dytë, të nenit 38, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e

Shqipërisë“, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Mjekët e përgjithshëm, të diplomuar në fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës kanë të drejtë të konkurrojnë për specializim pasuniversitar në mjekësi vetëm pasi të kenë punuar një vit në vendet e lira të punës në rrethe, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit shëndetësor.

2. Kanë të drejtë të konkurrojnë, pa përmbushur detyrimin e mësipërm, ata mjekë të përgjithshëm, që kërkojnë të specializohen në degët “Mjek i familjes”, “Mjek i shëndetit publik”, dhe “Anatomi Patologjike”.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin aktet, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**

**Nr.529, datë 5.10.2000**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR FUSHË-KRUJË-MILOT, NË TERRITORIN E KOMUNËS MILOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë-Milot.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhen këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 2 069 800 (dy milionë e gjashtëdhjetenëntë mijë e tetëqind) lekësh.

4. Fondi për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2000, miratuar për Ministrinë e Transportit, në zërin “Shpronësime”.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit tetor 2000.

6. Punimet për zbatimin e projektit të përfundojnë brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Lloji i pasurisë: tokë bujqësore me numër rendor 4

1	2			3	4	5	6	7
Nr.	Pronar			Sip m2	Çmimi i tokës bujq.	Vlera e tokës bujq.	Vlera e kult.bujq.	Totali në lekë
	Emër	Atësi	Mbiemër					
1.	Islam	Beg	Shabani	980	800	784 000	24 000	80 8000
2.	Pjetër	Ndue	Gjetani	600	800	480 000	10 500	490 500
3.	Mark	Pjetër	Çuni	568	800	454 400	17 500	471 900
4.	Ramazan	Ibrahim	Hysa	341	800	272 800	26 600	299 400
	Shuma:			2 489		1 991 200		2069 800

**V E N D I M**  
**Nr.532, datë 5.10.2000**

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT “STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITETIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të ligjit nr.7664, datë 21.1.1993, “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e studimit, që i shërben programit të qeverisë, “Strategjia dhe plani për biodiversitetin”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për të ndjekur zbatimin e studimit e të rekomandimeve të tij krijohet Këshilli Kombëtar për Natyrën dhe Biodiversitetin, me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale kryetar
- Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit sekretar
- Ministri i Mbrojtjesanëtar
- Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimitanëtar
- Ministri i Punëve Publikeanëtar
- Ministri i Financaveanëtar
- Ministri i Arsimit dhe Shkencësanëtar
- Ministri i Pushtetit Lokalanëtar
- Kryetari i Komitetit të Turizmitanëtar
- Kryetari i Akademisë së Shkencaveanëtar
- Drejtori i Institutit të Shëndetit Publikanëtar
- Përfaqësues i OJQ-ve mjedisoreanëtar

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të mbulojë shpenzimet e këtij këshilli.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.545, datë 6.10.2000**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË  
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR TIRANË-VORË, NË  
TERRITORIN E BASHKISË SË VORËS, PJESË E SUPERSTRADËS RRUGORE TIRANË-  
DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 5, pika 1, të nenit 20 dhe nenit 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Vorë, pjesë e superstradës rrugore Tiranë-Durrës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, i cili paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 4 919 250 (katër milionë e nëntëqindëntëmbëdhjetë mijë e dyqindëpesëdhjetë) lekë.
4. Fondi për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Transportit, në zërin "Shpronësime".
5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.11.2000.
6. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Nr.	Emri	Sipërfaqja në m2		Çmimi në L/m2	Vlera në lekë
		Tokë Bujq.	Truall		
1.	Shehap Hamdi Krasniqi		73 m		894 50 (70%)
2.	Sulejman Hamdi Krasniqi		94 m		1 645 000
3.	Hamdi Rexhep Krasniqi		136 m	175 00	2 380 000
	Shuma:		303 m2		4.919.250 lekë

**V E N D I M**  
**Nr.547, datë 5.10.2000**

**PËR PROJEKTIN PILOT TË SHTRIRJES SË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE NË  
SHËRBIMIN PARËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 e 36, të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shtrirjes së skemës së sigurimeve të kujdesit shëndetësor në shërbimin parësor të Tiranës, në kuadër të zbatimit të projektit të Bankës Botërore "Për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e sistemit shëndetësor".

2. Mbulimi, nga sigurimet shëndetësore, i shërbimit shëndetësor të kujdesit parësor për Tiranën, do të fillojë brenda 2 muajve nga data e funksionimit të plotë të Autoritetit Shëndetësor Rajonal dhe do të zgjasë për të gjithë kohën e projektit pilot të këtij autoriteti.

3. Për realizimin e këtij mbulimi, buxheti i planifikuar për poliklinikat dhe qendrat shëndetësore të Tiranës kalon nga Ministria e Shëndetësisë dhe organet e pushtetit vendor në Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, që në çastin e kalimit të kësaj veprimtarie në varësi të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, që, të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 39, datë 7.10.2000**

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET  
E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 1 TETOR 2000**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 07.10.2000 shqyrtoi rezultatet e shpallura nga Komisionet Zgjedhore të Qeverisjes Vendore, Njësive Bashkiake të Tiranës dhe komunave lidhur me zgjedhjet e zhvilluara me datën 01.10.2000 për organet e qeverisjes vendore.

Në këto zgjedhje u votua në 65 bashki, në 11 njësitë bashkiake të Tiranës dhe në 306 komuna. Në komunën Grekan të rrethit Elbasan votimi është shtyrë për në 29 Tetor 2000, për shkak të vdekjes së njërit prej kandidatëve, ndërsa në komunat Pult dhe Shalë të rrethit Shkodër nuk u zhvilluan votimet për shkak të mosfunksionimit të komisioneve zgjedhore.

Për herë të parë në Shqipëri, votimi u zhvillua me lista zgjedhore të hartuara në kuadrin e Regjistrimit Kombëtar të Zgjedhësve në zbatim të nenit 154 të ligjit Nr. 8609 datë 08.05.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Në listat përfundimtare të zgjedhësve janë regjistruar 2 329 014 zgjedhës të ndarë në çdo njësi vendore e për çdo qendër votimi përkatëse.

Për sa më lart në mbështetje të nenit 153 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të pikës 4 të nenit 18, pikës 4 të nenit CAPut! të ligjit Nr. 8609 datë 08.05.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

## V E N D O S I:

1. Të konsiderojë të përfunduar procesin zgjedhor të raundit të parë për këshillat vendore në 65 bashki, në 11 njësitë bashkiake të Tiranës, dhe në 306 komuna.

2. Për parregullsi gjatë procesit zgjedhor dhe për shkelje të ligjit, në bazë të nenit 113 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” KQZ deklaroi të pavlefshme votimet e datës 1 Tetor 2000 për këshillat vendore si më poshtë:

Në komunën Ksamil rrethi Sarandë për kryetarin e komunës, në komunën Velipojë, rrethi Shkodër; në qendrën e votimit Nr. 6 për këshillin dhe kryetarin e komunës, në komunën Ballagat, rrethi Lushnje për kryetarin e komunës; në komunën Paskuqan, rrethi Tiranë për këshillin dhe kryetarin e komunës; në komunën Kodovjat, rrethi Gramsh për këshillin; .

Në komunën Pult dhe Shalë të rrethit Shkodër ku votimi nuk ka filluar.

Në komunat dhe qendrat e votimit të mësipërme zgjedhjet do të përsëriten më datë 15.10.2000.

3. Në zgjedhjet e zhvilluar në 1 Tetor 2000 për kryetar bashkie, nga 65 bashki, është shpallur fituesi në 37 bashki.

Në 28 bashki do të zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve më 15 Tetor 2000, pasi në raundin e parë asnjë kandidat nuk ka fituar më shumë se 50 % të votave të vlefshme.

Mbi bazën e vendimeve të KZQV rezultoi se vendet e kryetarëve të bashkive sipas subjekteve zgjedhore janë fituar nga:

### **Partia Socialiste, gjithsej në 28 bashki dhe konkretisht në:**

Berat	Belsh	Ersekë
Konispol	Gramsh	Leskovik
Kuçovë	Librazhd	Pogradec
Çorovodë	Fier	Lezhë
Poliçan	Patos	Koplik
Burrel	Lushnje	Tiranë
Durrës	Gjirokastrë	Rogozhinë
Manëz	Memaliaj	Vlorë
Elbasan	Përmet	
Cërrik	Maliq	

### **Partia Demokratike gjithsej në 9 bashki dhe konkretisht në:**

Bulqizë	Krumë	Mamurras
Shijak	Bajram Curri	Shkodër
Kukës	Rubik	Kavajë

Në raundin e dytë të 15 Tetorit 2000, konkurojnë sipas njërive vendore kandidatët e mbështetur nga këto subjekte:

Nr	Subjektet	Nr. Njësive ku konkuron
1.	Partia Socialiste	Në 144 njësi vendore
2.	Partia Socialiste + Partia Socialdemokrate	Në 3 njësi vendore
3.	Partia Socialiste + PBDNJ	Në 1 njësi vendore
4.	Partia Socialiste + PASH	Në 4 njësi vendore
5.	Partia Socialdemokrate	Në 14 njësi vendore
6.	Partia Socialdemokrate + PSSH	Në 1 njësi vendore

7.	Aleanca Demokratike	Në 6 njësi vendore
8.	Partia Demokratike + PLL + PBL + PBKD + PBD	Në 123 njësi vendore
9.	Partia Republikane	Në 8 njësi vendore
10.	Partia e Bashkimit të Drejtave të Njeriut	Në 6 njësi vendore
11.	E Djathta e Bashkuar	Në 3 njësi vendore
12.	Partia Balli Kombëtar Demokra + PD + PLL + PBL + PBD	Në 1 njësi vendore
13.	Partia Demokristiane	Në 1 njësi vendore
14.	Partia Lëvizja e Legalitetit	Në 1 njësi vendore
15.	Partia Lëvizja e Legalitetit + PD + PBL + PBD + PBDK	Në 1 njësi vendore
16.	Partia Bashkimi Demokrat + PD + PLL + PBKD + PBL	Në 1 njësi vendore
17.	Kandidat të pavarur.	Në 9 njësi vendore
18.	Partia Republikane + PD + PLL + PBL + PBDK + PBD	Në 1 njësi vendore

1. Për njësitë bashkiake të Tiranës, mbi bazën e vendimeve të KZQV përkatëse, vendi i kryetarit të njësisë bashkiake është fituar nga kandidati i mbështetur nga Partia Socialiste në njësinë bashkiake Nr. 5.

Në 10 njësitë bashkiake të tjera do të zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve më 15 Tetor 2000, pasi në raundin e parë asnjë kandidat nuk ka fituar më shumë se 50% të votave të vlefshme.

2. Mbi bazën e vendimeve të KZQV-ve rezulton se vendet e kryetarëve të komunave sipas subjekteve zgjedhore janë fituar nga:

Partia Socialiste, gjithsej në 110 komuna.

Partia Demokratike, gjithsej në 58 komuna.

Partia PBDNJ, gjithsej në 5 komuna.

Partia PLL, gjithsej në 1 komunë.

Në raundin e dytë të zgjedhjeve të 15 Tetorit 2000, do të zhvillohen zgjedhje në 128 komuna.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke shpallur rezultatet e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 1 Tetor 2000 deklaroi se ato janë të plota vetëm për ato bashki, komuna e njësi bashkiake ku ka përfunduar procesi zgjedhor.

4. Të dhënat e hollësishme dhe të plota i bashkëngjiten këtij vendimi në tabelat përkatëse.

5. Ky vendim u shpall sot më datë 7.10.2000

Zv.KRYETARI  
Mimoza ARBI

KRYETARI  
Prof. Dr. Fotaq NANO

ANËTARË :

Shahin BISTRIT  
Maksim SHIMANI  
Klement ZGURI

Pandeli VARFI  
Gaspër KOKAJ

**V E N D I M**  
**(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)**

Gjykata, konform nenit 306, 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, 75 e vijues të Kodit Civil vendosi shpalljen si të zhdukur të Dashamir Maksut Muçollarit që nga data 4.9.1996.

**K Ë R K E S Ë**  
**(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)**

Kërkuesi: Spiro Avrami, i biri i Vasilit, lindur në Përmet e banues në Tiranë, në adresën rruga “Emin Duraku”, nr.6, banesë private.

Objekti: Kërkoj të shpallet i zhdukur shtetasi Dhimitër Avrami, i biri i Vasilit dhe i Meropit, lindur më 27.11.1920, në Përmet.

Baza ligjore: Neni 375 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

Unë kërkuesi Spiro Avrami, kërkoj të shpallet i zhdukur vëllai im Dhimitër Avrami.

Largimi i tij, është bërë rreth viteve 1942-1943 dhe që nga ajo kohë ne nuk kemi asnjë të dhënë për vendndodhjen e tij. Kemi bërë përpjekje nëpërmjet organizatave të ndryshme humanitare si Kryqi i Kuq etj, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Në momentin e largimit ai ka qenë rreth moshës 20 vjeç. Duke parë se ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe nuk dimë asgjë për vendqendrimin e tij, kërkojmë nga Gjykata shpalljen si të zhdukur të shtetasit Dhimitër Avrami.

**KËRKUESI**  
**Spiro Avrami**

**K Ë R K E S Ë**

Kërkuese: Natasha Duda, e bija e Zoit, lindur më 1959, banuese në fshatin Bicakaj e Vjetër (Allkaj) të qytetit të Lushnjes.

Objekti: Shpalljen të vdekur të Lami Dudës.

Baza ligjore: Neni 375 e vijim i Kodit të Procedurës Civile.

Unë kërkuesja Natasha Duda, kërkoj të shpallet i vdekur bashkëshorti im Lami Duda.

Më 12 prill të vitit 1993, ai së bashku me të vëllanë e tij u nisën në Greqi për të punuar. Mbas një konflikti që lindi midis një qytetari grek ata u detyruan të kthehen në Shqipëri. Më datën 18 prill 1993, vëllai i tij kthehet, ndërsa për bashkëshortin tim nuk kemi asnjë lajm se ku ndodhet. Si trashëgimtare e tij jam unë dhe dy fëmijët.

Sa më sipër kërkojmë nga Gjykata të shpallet i vdekur shtetasi Lami Duda.

**KËRKUESJA**  
**Natasha Duda**

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 20.10.2000  
Doli nga shtypi më 23.10.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 150 lekë